



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:168493

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06278411

C.nr.2609/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike - SH.A (KEDS) me adresë në Prishtinë - Distrikti në Prizren, kundër të paditurit H.G. nga Prizrenit, me objekt kontesti kompensim dëmi material, vlera e kontestit 496.94 euro, në seancën përgatitore të datës 10.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATROHET E TËRHEQUR padia me numër të dosjes C.nr.2609/2022 e paditëses Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike - SH.A (KEDS), kundër të paditurit H.G. nga Prizreni, me objekt kontesti kompensim dëmi material, në këtë çështje juridiko kontestimore.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare Për Distribuim Dhe Furnizim Me Energji Elektrike - SH.A (KEDS), pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padinë kundër të paditurit H.G. nga Prizreni, me objekt kontesti kompensim dëmi material, vlera e kontesti 496.94 euro.

Me parashtrësën e datës 26.09.2024 dorëzuar në gjykatë më datë 01.10.2024 paditësja është tërheq nga padia.

Gjykata paraprakisht ka caktuar seancën për shqyrtimin përgatitor për datën 10.10.2024, në të cilën ka prezantuar vetëm i padituri, i cili ka deklaruar se jep pëlqimin për tërheqjen e padisë, si dhe nuk i kërkon shpenzimet e procedurë.

Numri i lëndës: 2022:168493

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06278411

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261 të LPK-së, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se paditësja e ka tërhequr padinë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 2609/2022, të datës 10.10.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, bazuar në nenin 261.4 të LPK-së.